



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Nr. 509/prot.
55

Tiranë, më 27.12.2022

VENDIM

Nr. 908, Datë 27.12.2022

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË VENDIMIT NR. 823, DATË 02.09.2021 “PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE DHE GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE DHE DHËNIEN E DISA DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES FLORFARMA SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27.12.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbyllja e procedurës së monitorimit të zbatimit të vendimit nr. 823, datë 02.09.2021 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave dhe dhënieve të disa detyrimeve ndaj ndërmarrjes Florfarma SHPK”.

Bazë ligjore: Neni 24, germa (d) dhe neni 26 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Raportit të monitorimit mbi zbatimin e vendimit nr. 823, datë 02.09.2021.

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës në përfundim të procedurave të hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 43, pika (5) dhe nenin 45, pika (2) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me

me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjes Florfarma SHPK”, vendosi:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Florfarma SHPK në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
 - II. Detyrimin e ndërmarrjes Florfarma SHPK të mos bëjë marrëveshje dhe/ose praktika të bashkërenduara, të cilat kanë si objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtreberimin e konkurrencës në treg, veçanërisht:
 - a. të caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
 - b. të kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;
 - c. të ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;
 - d. në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
 - e. të kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.
 - III. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja Florfarma SHPK në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohet me penaltetin përkatës.
 - IV. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Florfarma SHPK për një periudhë 12 mujore nga marrja e vendimit.
2. AK në kuadër të monitorimit të zbatimit të kushteve dhe detyrimeve të VKK nr. 823, datë 02.09.2021, ka bashkëpunuar me ndërmarrjen Florfarma SHPK duke administruar informacionin, si më poshtë vijon:
- AK me shkresën nr. 509/5 prot., datë 01.08.2022 dhe shkresën nr. 509/16 prot., datë 31.08.2022 “Kërkesë për informacion” drejtuar ndërmarrjes Florfarma SHPK ka kërkuar informacion mbi blerjet, shitjet analitike, sasinë e prodhuar dhe koston për produktet maska, xhel desinfektant, alkool dhe termometra infrared, për periudhën 02 shtator 2021 – 31 korrik 2022.
 - Ndërmarrja Florfarma SHPK me shkresën nr. 509/22 prot., datë 2.9.2022 “Kthim Përgjigje” dhe me emailin e datës 12.08.2022 “Informacioni sipas shkresës nr. 509 datë 1.8.2022”, (protokolluar pranë AK me nr. 509/24 prot. datë 06.09.201) ka informuar në lidhje me zbatimin kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në VKK nr. 823/2021.
3. Nga administrimi dhe përpunimi i informacionit për ndërmarrjen Florfarma SHPK, konstatohet se kjo ndërmarrje për periudhën e monitorimit ka treguar produktet alkool dhe gel dezinfektues.
- i. Lidhur me analizën e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të maskave**
4. Produkti maska është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë. Referuar të dhënave teknike dhe cilësore të tyre, maskat janë ndarë në katër kategori: maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP3, maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP2 (N95), maskë kirurgjikale e thjeshtë dhe maskë prej pëlhere.

5. Ndërmarrja Florfarma SHPK, përgjatë periudhës së monitorimit 2 shtator 2021 – 31 korrik 2022 nuk ka tregtuar produktin maskë.

ii. Lidhur me analizën e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel Dezinfektues

ii.1 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve

6. Produkti alkool është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, alkooli ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të gradës dhe sasisë në paketim.
7. Për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjes Florfarma SHPK, grupi i punës i ka analizuar produktet të klasifikuar Alkool të ndara sipas tetë kategorive: (i) Alkoole 70% me paketim 1 litër ose më shumë; (ii) Alkoole 90% me paketim 1 litër ose më shumë; (iii) Alkoole 90% me paketim 100 - 250 mililitër ; (iv) Alkoole mbi 90% me paketim 1 litër; (v) Alkoole 70% me paketim 100 - 250 mililitër; (vi) Alkoole 70% me paketim 250 mililitër; (vii) Alkoole të ndryshme 70%-95% me paketim 1 litër; (viii) Alkoole 70% me paketim 750 mililitër.
8. Ndërmarrja Florfarma SHPK, prodhon vetëm alkool të përqendrimit 70% me paketim 100 mililitër dhe 1 litër. Përgjatë periudhës së monitorimit 2 shtator 2021 – 31 korrik 2022, kjo ndërmarrje ka treguar Alkool 70 Florfarma- (1L) në sasi 7 191 flakonë dhe Alkool 70 Florfarma 100 ml në sasi 18 476 flakonë.
9. Në fund të analizës për kategorinë e produktit Alkool është konstatuar se ndërmarrja Florfarma SHPK ka aplikuar çmime mesatare të shitjes të ndryshme nga çmimet që kanë aplikuar ndërmarrjet e tjera përgjatë periudhës së monitorimit dhe për pasojë nuk ka shkelje në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003.

ii.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel Dezinfektues

10. Produkti gel Dezinfektues është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, produkti gel Dezinfektues ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të sasisë së paketuar.
11. Për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjes Florfarma SHPK, grupi i punës i ka analizuar produktet të klasifikuar Gel Dezinfektues të ndara sipas kategorive: Gel Dezinfektues 1L; Gel Dezinfektues 100ml; Gel Dezinfektues 80ml dhe Gel Dezinfektues 500ml.
12. Ndërmarrja Florfarma SHPK, prodhon vetëm Gel Dezinfektues Bactiflor 0.95 litër dhe 1 litër. Përgjatë periudhës së monitorimit 2 shtator 2021 – 31 korrik 2022, kjo ndërmarrje ka treguar Bactiflor 0.95 litër në sasi 1 459 flakonë dhe Bactiflor 1 litër në sasi 6 525 flakonë.
13. Në fund të analizës për kategorinë e produktit Gel Dezinfektues është konstatuar se ndërmarrja Florfarma SHPK ka aplikuar çmime mesatare të shitjes të ndryshme nga çmimet që kanë aplikuar ndërmarrjet e tjera përgjatë periudhës së monitorimit dhe për pasojë nuk ka shkelje në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003.

iii. Lidhur me analizën e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave

14. Produkti termometër infrarred është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë.
15. Ndërmarrja Florfarma SHPK, përgjatë periudhës së monitorimit 2 shtator 2021 – 31 korrik 2022 nuk ka treguar produktin termometër.
16. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjes Florfarma SHPK në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave; në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkoolit; në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezinfektues dhe në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometër nuk konstatohet ekzistenca e një sjelljeje të bashkërenduar e cila bie në kundërshtim me nenin 3, pika 4, nenin 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
17. Për sa më sipër. kushtet dhe detyrimet të dhëna në pikën II të dispozitivit vendimit nr. 823, datë 02.09.2021, janë zbatuar nga ndërmarrja FLORFARMA SHPK.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d) dhe nenin 26 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së monitorimit në zbatim të vendimit nr. 823, datë 02.09.2021 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjes Florfarma SHPK”.
 - II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA

()


Zv/Kryetar

Rezana KONOMI

()

Anëtar

Adriana BERBERI

()

Anëtar

Durim KRAJA

()

Anëtar

Denar BIBA

()

Kryetar

